



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:153528

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05503031

**CAP.nr.147/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbartimore të kreditorit Halit Azemi nga Komuna e Gjilanit, me adresë “Sheshi i pavarësisë”, Nr.154, ndaj debitorit S.M, nga fshati H, Komuna e K..., me bazë juridike pagim i borxhit, vlera e kompensimit 10,600.00 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, PPP.nr.12/21 të datës 13.12.2022, me datë 26.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e debitorit S.M, nga fshati H, Komuna e K..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, PPP.nr.12/21 të datës 13.12.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore Gjilan-Dega në Kamenicë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.12/21 të datës 13.12.2022, në pikën -I-, të dispozitivit, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit S.M fshati H, Komuna e K..., në pikën -II-, ka aprovuar propozimin e kreditorit H.A nga Gjilani Sh.P, Nr..., në pikën -...-, ka lënë në fuqi urdhrin P.nr.292/21 datë 16.06.2012, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi, nga Gjilani, ndërsa anë pikën -IV-, e ka obliguar debitorin Sabit Morina, që t'ia kompensoj e shpenzimet e procedurës në shumë prej 312.00 euro, në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim si dhe shpenzimet e përmbartuesit privat, në shumë prej 82.60 euro, të gjitha në aftë prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit e

Kosovës, ta aprovoj në tersi ankesën e debitorit dhe ta ndryshoj apo ta anuloj aktvendimin PPP.nr.12/21 dhe lënda të kthehet në ri procedurë.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar kreditori duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareme si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

### **-Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbareme ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbareme-aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë, C.nr.128/2016 të datës 27.05.2019, i plotfuqishëm nga data 25.06.2029 dhe i ekzekutueshëm nga data 18.05.2021. Përmbaremi privat ka lejuar përmbaremin e kërkuar nga debitori me urdhrin P.nr.292/21 të datës 16.06.2012, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 30.06.2021, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 07.07.2021. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, organi përmbaremi e cakton përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbaremi dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbaremi, në bazë të dokumentit përmbaremi, organi përmbaremi e cakton përmbaremin vetëm në bazë të titullit përmbaremi sipas dispozitë së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, si dokument përmbaremi është: “*vendimi përmbaremi i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbareme*”. Në këtë rast titull përmbaremi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega Kamenicë, C.nr.128/2016 të datës 27.05.2019, i plotfuqishëm nga data 25.06.2019 dhe i ekzekutueshëm nga data

18.05.2021. Dokument përmbareues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së është përcaktuar se: *“vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujudi gjyqësore konsiderohet ujudia e arritur para gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”*, dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me aktgjykim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit se arsyetimi është i pa qartë kontradiktor dhe nuk janë dhënë arsye të mjaftueshëm lidhur me vendosjen si në dispozitiv të vendimit, Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për arsye se në arsyetim e aktvendimit të atakuar janë dhënë arsye të qarta dhe konkrete për lejimin e përmbarimi për faktin se aktgjykimi C.nr.128/2016 të datës 27.05.2019, në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është i përshtatshëm për përmbarim ngase i njëjti e përmban klauzolën e plotfuqishmërisë nga data 25.06.2019 dhe të ekzekutueshmërisë 18.05.2021. Andaj, në rastin konkret i njëjti i plotëson kushtet sipas dispozitave të LPP-së, për të qenë dokument përmbareues.

Ndërsa lidhur me pretendimin se gjykata fare nuk është lëshuar në seancë gjyqësore për të vendosur lidhur me kundërshtimin e debitorit, dhe se debitori ka kërkuar shtyrjen e seancës, Gjykata ankimore një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, për faktin se gjykata në procedurën përmbarimore nuk ka tagër të lëshohet në ligjshmërinë e dokument përmbareues, ndërsa këto pretendime debitori ka mundur që ti paraqes në procedurën e zhvilluar kontestimore. Në procedurën përmbarimore, organi përmbareues apo gjykata e cakton dhe zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues siç është aktgjykimi C.nr.128/2016 të datës 27.05.2019, i plotfuqishëm nga data 25.06.2019 dhe i ekzekutueshëm nga data 18.05.2021, i cili i plotëson kushtet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, për të qenë dokument i përmbareues. Andaj, në bazë të asaj që u tha më lartë aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të vërtetohet dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pabazuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**CAp.nr.147/2023 me datë 26.03.2024**

**Gjyqtari**  
Adnan Konushevci